



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000797/7

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandohet pajisja e IEVP Tepelene me autoambulancë si dhe mbajtja e procesverbalit nga stafi përgjegjës në rastet kur i burgosuri refuzon të marrë trajtim mjekësor ose të kryejë ekzaminimet e rekomanduara nga mjeku*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE
Tiranë

IEVP TEPELENË

Të nderuar zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi K. Zh., i cili ka pretenduar se familja Zh. nuk ka marrë informacion nga IEVP Tepelenë për rrethanat e arsyes së vdekjes së xhaxhait të tij A. Zh. në datën 30.04.2019, gjatë kohës që qëndronte i paraburgosur në këtë institucion. Gjithashtu ankuesi hedh dyshime se ka patur neglizhencë nga stafi i IEVP-së për t'i dhënë shërbim shëndetësor A. Zh., i cili ka patur probleme me zemrën.

Për verifikimin e kësaj ankese jemi interesuar fillimisht në IEVP Tepelenë. Në përgjigjen¹ që kemi marrë thuhet se: shtetasi A. Zh. është pranuar në IEVP në cilësinë e të paraburgosurit në datën 19.11.2018. Gjatë qëndrimit në IEVP, ai nuk ka shfaqur shqetësime të karakterit shëndetësor. Vizitat i janë kryer rregullisht nga stafi shëndetësor i IEVP-së. I vetmi medikament që ka përdorur ka qenë paracetamoli, të cilin e kërkonte për të qetësuar dhimbjen e kokës. Marrëdhëniet me bashkëvuajtësit e sektorit i ka pasur shoqërore, ndërsa takimet me familjarët i ka pasur të rralla.

¹ Shkresa Nr.1728 prot., datë 16.09.2019.

Në datën 30.04.2019, në orën 06:20, punonjësi i sektorit ku qëndronte i paraburgosuri A. Zh., ka njoftuar specialistin e informacionit, se ky i paraburgosur kishte probleme të rënda shëndetësore. Në orën 06:23, specialisti i informacionit, i shoqëruar nga punonjës të tjerë të policisë dhe ndihmësmjeku i turnit ka hyrë në dhomën e A. Zh., të cilin e kanë gjetur në gjëndje të vështirë shëndetësore. Ndhimësmjeku i ka dhënë ndihmën e parë dhe ka kërkuar dërgimin e tij në spitalin rajonal. Në orën 06:33, A. Zh. është nxjerrë nga regjimi i brendshëm me barrelë dhe është tentuar për ta hipur fillimisht në automjetin tip Mitsubishi, por ky automjet nuk ka qenë i përshtatshëm pasi i paraburgosuri duhej të vendosej në barrelë. Në këto rrethana, i paraburgosuri është vendosur me vështirësi në një automjet tjetër tip Fiat, për shkak se dera e makinës ka qenë e ngushtë, dhe në orën 06:37 është nisur për në Spitalin e Tepelenës, ku ka mbërritur në orën 06:40. Megjithëse shtetasit A. Zh. i është dhënë ndihma e parë, rreth orës 06:55, ai ka ndërruar jetë. Me telefon janë njoftuar familjarët e të ndjerit dhe Komisariati i Policisë Tepelenë. Për këtë ngjarje kanë kryer hetime Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Sipas informacioneve që IEVP-ja ka marrë për ngjarjen nga shokët e dhomës, ata janë shprehur se A. Zh. nuk ka shfaqur shqetësime dhe një ditë para ngjarjes gjendja e tij ka qenë normale dhe ka ndjekur televizor deri pas mesnate. Familjarët e të ndjerit i janë drejtuar me ankesë Presidentit të Republikës, institucion të cilit i është kthyer përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Po ashtu, familjarët kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, ku është vënë në dispozicion dokumentacioni që i shërben hetimit të ngjarjes.

Nga këqyrja e kartelës klinike të të paraburgosurit A. Zh. u konstatua se, në datën kur ky i paraburgosur është pranuar në IEVP Tepelenë ka referuar se vuante nga zemra prej 15 vitesh dhe se nëna kishte vuajtur gjithashtu nga zemra. Mjeku i IEVP-së ka shënuar në kartelë se i paraburgosuri duhet të planifikohet për të kryer disa ekzaminime si EKG, Eko abdominale, gjak komplet, urinë komplet dhe skopi. Poshtë këtij shënimi është shkruajtur *ka refuzuar analizat mjekësore.*

Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tepelenë iu kërkua të na informonte gjithashtu nëse ishte pajisur me autoambulancë institucioni dhe nëse familjarët e të paraburgosurit A. Zh. kishin paraqitur ankesë/kërkesë me shkrim për t'u njohur me rrethanat e vdekjes së tij. Në përgjigjen² që kemi marrë thuhet se IEVP-ja nuk është e pajisur me autoambulancë dhe se familjarët e të paraburgosurit A. Zh. nuk kanë paraqitur ankesë/kërkesë.

Për sa i përket kallëzimit të familjarëve të të ndjerit, për më tepër informacion i jemi drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë si edhe Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Në përgjigjet që kemi marrë jemi vënë në dijeni se, në lidhje me rastin ishte regjistruar procedimi penal nr.295, datë 02.05.2019. Organi i prokurorisë ka kërkuar dy herë në gjykatë pushimin e çështjes penale, por kërkesat nuk janë pranuar nga gjykata dhe është urdhëruar vazhdimi i hetimeve brenda një afati të caktuar duke u vendosur detyrat përkatëse. Afati i lënë nga gjykata nuk është respektuar për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19. Aktualisht çështja po shqyrtohet sërish në gjykatë.

Pas vlerësimit të informacioneve dhe dokumentacionit të administruar, në përfundim të hetimit tonë administrativ konstatojmë se: dinamika e ngjarjes tregon qartë se për shkak

² Shkresa Nr.356 prot., datë 04.03.2020.

të mungesës së një automjeti të përshtatshëm për transportimin e të paraburgosurit A. Zh. për në spitalin rajonal, kanë humbur minuta të vlefshme për ta dërguar atë sa më parë në një institucion ku mund të merrte trajtim më të specializuar dhe mund të shpëtohej një jetë. Mungesa e autoambulancës është konstatuar edhe gjatë inspektimit që ka kryer në datën 11.12.2019 Mekanizimi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës. Me shkresën tonë Nr.K4/I76-3 Prot., datë 01.06.2020 ju është dërguar raporti i inspektimit të kryer në I EVP Tepelenë dhe ndër të tjera është rekomanduar marrja e masave për pajisjen e institucionit me ambulancë për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit (pika 11 e rekomandimit).

Për sa i përket shërbimit shëndetësor që i është ofruar të paraburgosurit A. Zh., ashtu si edhe në raste të tjera evidentojmë se, kur i burgosuri refuzon të marrë medikamentet dhe të kryejë ekzaminimet e rekomanduara nga mjeku, stafi shëndetësor i I EVP-së mjaftohet vetëm me shënimin në kartelën klinike se “i burgosuri refuzoi”. Gjatë praktikës së trajtimit të ankesave kemi konstatuar disa raste kur i burgosuri është shprehur se nuk qëndron argumenti që ka refuzuar të marrë medikamentet, por I EVP-ja nuk i ka siguruar medikamentin e rekomanduar nga mjeku specialist për shkak të kostos ose kanë refuzuar të marrin medikamentet e rimbursueshme, me arsyetimin se nuk janë cilësore, dhe jo medikamentin me emrin tregtarë që ka rekomanduar mjeku specialist. Duke patur parasysh këto ankesa ka lindur nevoja që refuzimi i të burgosurit për të marrë medikamente apo për të kryer ekzaminime të dokumentohet në një procesverbal të nënshkruar prej tij dhe punonjësve të I EVP-së dhe në rast se i burgosur nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin, ky dokument të nënshkruhet nga më shumë se një punonjës dhe të depozitohet pranë shërbimit ligjor me numër protokolli të brendshëm, në mënyrë që të evidentohet në kohë kryerja e veprimit.

Kujtojmë se, në përfundim të hetimit të ankesës së paraqitur nga përfaqësuesi ligjor i të dënuarit G. K. lidhur me trajtimin e tij shëndetësor, ndër të tjera kemi rekomanduar³ që të dënuarit t’i vihet në dispozicion rekomandimi i mjekut specialist lidhur me trajtimin e tij me barna mjekësore dhe në rast se ai nuk pranon të marrë barnat që siguron I EVP-ja, por ato që siguron familja të mbahet procesverbal i përkatës.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”.

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e I EVP Tepelenë me autoambulancë, për të garantuar ofrimin e shërbimeve dhe shoqërimin e të burgosurve për trajtim më të specializuar në institucionet shëndetësore;

³ Rekomandim i dërguar me Shkresën Nr.K2/S30-15 Prot., datë 13.12.2019.

- Marrjen e masave të nevojshme për mbajtjen e proceverbalit nga stafi përgjegjës në rastet kur i burgosuri refuzon të marrë medikamente apo të kryejë ekzaminimet e rekomanduara nga mjeku dhe komunikimin e tij me procesverbal në sektorin shëndetësor për t'u këshilluar më tej i burgosuri me pasojat e këtij veprimi.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi